



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.62-2//2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj, dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për rishqyrtim ZL.Anr.62-4/2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it ZL.Anr.62/2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR kërkesa për rishikim ZL.Anr.62 -6/2025 e datës 26.09.2025, e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin e vendimit të PZAP-it, ZL.Anr.62/2025 të datës 26.09.2025, me të cilin i është shqiptuar dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00 euro (pesëqind euro), ka detyruar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

Arsyetim

Paneli me vendimin ZL.Anr.62/2025, të datës 26.09.2025, e kishte miratuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00 euro (pesëqind euro), ka detyruar subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

PZAP-i, me datë 26.09.2025, ka pranuar kërkesën për rishqyrtim e vendimit ZL.Anr.62-6/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendohet posterat e vendosur me material promovues nga subjekti politik PDK, Me këtë shkresë, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqet kërkesën për rishqyrtim të Vendimit nr. ZL.An.62/2025, me të cilin është shqiptuar gjoba në shumë prej 500 euro, lidhur me vendosjen e një posteri në hapësirë publike në Ferizaj nga kandidati për Asamble Komunale, z. Maliq Muharremi.

Në kërkesë për rishqyrtim të vendimit subjekti politik PDK ka siguruar Vendimin nr. 376/2025, datë 14.05.2025, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Ferizajt, me të cilin është dhënë pëlqimi zyrtar për kompaninë "MB Paramount" Sh.P.K. — kompani me të cilën

kandidati, z. Maliq Muharremi, ka pasur kontratë për vendosjen e posterit në fialë. Ky fakt dëshmon qartë se veprimi për të cilin jeni ndëshkuar është kryer me leje të rregullt institucionale, dhe rrjedhimisht nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Duke marrë parasysh faktet e reja të paraqitura, vendimin e organeve kompetente komunale, kontratën e ligjshme të kandidatit dhe parimin e sigurisë juridike, kërkojnë që PZAP të rishqyrtojë vendimin nr. ZL.An.62/2025 në përputhje me nenin 18, paragrafi 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe, si rezultat i këtij rishqyrtimi, të shfuqizojë masën ndëshkuese të shqiptuar ndaj Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), përkatësisht të heqë gjobën prej 500 euro, pasi nuk ka pasur shkelje të qëllimshme apo veprim të jashtëligjshëm nga ana e subjektit tonë politik apo kandidatit të tij.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se;

Kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit ZL.Anr.62-6/2025, të datës 26.09.2025, është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës përkatësisht kërkesës për rishqyrtim të datës 26.09.2025, qe ta shqyrtoj vendimit ZL.Anr.62/2025, të datës 26.09.2025, rrjedh se subjekti politik PDK nuk ka arritur që të vërtetojë pretendimet e parashtruara në kërkesë, kjo për faktin se Paneli gjatë shqyrtimit të provave gjegjësisht Vendimi me nr. të referencës 376, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt, të datës 14.05.2025, ka vërejtur se me këtë vendim i është dhënë pëlqimi personit Bekim Çalaj për vendosjen e Led ekranit në nënkalimin e këmbësorëve, po ashtu me këtë vendim Bekim Çalaj është obliguar që të lidhë kontratë të qirasë me Drejtorinë për Financa të Komunës së Ferizajt. Në këto rrethana Paneli konstatoi se nuk është ofruar ndonjë dëshmi që tregon se Bekim Çalaj ka lidhë kontratë të qerasë me Drejtorinë për Financa të Komunës së Ferizajt, po ashtu nuk ka dëshmi që tregojnë se i njëjti ka të drejtë që të njëjtat hapësira reklamuese ti jap me qira personave të tretë, në këtë rast dëshmia e ofruar nga subjekti politik PDK, nuk mund të merret si dëshmi e bazuar, pasi qe si e tillë kjo dëshmi ka qene ne vlerësim te panelit edhe kur është marr vendimi ZL.Anr.62/2025, i datës 26.09.2025,

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga provat e përshkruara në kërkesë nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e theksuara si më lart.

Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht neni 118 paragrafi 4, me të cilin përcaktohet se, *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.62-2/2025, datë 03.10.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*